REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITYOF LIPJAN

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

Datë:	**16.06.2022**
Referenca:	
Për :	**z. Imri Ahmeti** - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje :	**z. Diamant Bytyqi** - Nënkryetar i Komunës **z. Lulzim Qerimi** – Nënkryetar për Komunitete
Nga:	z.Valon Pacolli - Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda:	**Raport për muajin Maj - 2022**

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë këtij muaji në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale, si dhe obligime të tjera nga e drejta pozitive në përgjthesi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- Takime me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë – Dorëzimi i paramasës për finalizimin e fazës së parë për ZE Qylagë.
- Takime me përfaqësuesit e UNDP-së dhe Ministrisë së Kulturës lidhur me projektin e "Rivitalizimit të Janejvës".
- Takime me lokalitetin e Janjevës për projektin "Rivitalizimi i Janjevës"
- Takime me Organizatën ASB, Preda Plus.
- Takime me biznese të ndryshme.
- Zhvillim i mëtutjeshëm i fazës së parë të ZE Qylagë nëpërmjet Kuvendit për shpalljen e konkursit për pranim të bizneseve.
- Takime me Komisionin Vlerësues për pronat e ZK Konjuh.
- Takime me bordin e Aksionarëve të KRM Pastrimi si dhe takime me Komisionin e Aksionarëve Lipjan.

- Takime dhe inicim i procedurave nga departamenti ynë për monitorimin e shfrytëzuesve afatgjatë dhe afatshkurtë të pronave komunale, si dhe inicim për procedurë të shkruar lidhur me ndarjen e përgjegjësive si dhe inkasimin e të hyrave nga departamentet përkatëse.
- Monitorues në hartimin e raportit për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2019-2023.
- Kërkesë Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër për parcializimin e fazës së parë të ZE Qylagë.

STATISTIKAT

Zyra për regjistrim të Bizneseve:

1.	**Biznese të reja të regjistruara**	**30**
2.	**Shuarje e bizneseve**	**1**
3.	**Lëndë të refuzuara**	**0**
4.	**Ndrrimi i Çertifikatave të Bizneseve**	**6**
5.	**Lëndë të kryera**	**64**